


Poezia e sotme amerikane në përkthimin e poetit Gjeko Marinaj

Frederick (Frederik) Turner është i njohur si një nga poetët më cilësor në letërsinë e sotme botërore. Nëse lexuesi shqiptar do të hezitohet ta pranojë si të tillë, faji nuk mund të kërkohet në punën e tij si poet, por në punën time si përkthyes. Nuk mund të jetë ndryshe, sepse vargjet e tij janë thellësisht të fuqishëm, midis tjerash, nga intelekti i një profesori të shquar në fushën e njerëzimit, nga imagjinata dhe mendimet e një filozofi të sofistikuar, dhe nga një poet që ka kontroll të përhershëm mbi estetikën dhe kodet e tjera, të vjetra dhe të reja, të poezisë. Ndonëse të zgjedhura nga më se dymijë poezi, poezitë e përfshira "Në Shpellën e Platonit" nuk janë pa tjetër poezi të më të arrira të poetit anglo-amerikan, por më tepër shembuj nga shumëllojshmëria stilistike e poetit Frederick Turner. Gjithsesi, këtu kemi të bëjmë me një kulm të ri të natyrës poetike, me një punë dytëshe që në aspektin historik, shpërthimi poetik shënon një pikë kthese për tek origjina e vjetër e poezisë, kurse në aspektin e risisë kemi të bëjmë me një poezi ku gjuha dhe imazhet, intimiteti dhe perspektiva, dashuria dhe shpresa riformohen për të gjetur një kimi të përbashkët me lexuesin. Kjo është e rëndësishme veçanërisht kur dimë se rreth pesëdhjetë vjet më parë, kur Turner filloi të botojë për herë të parë, bota ishte gjerësisht e dominuar nga tradicionalizmi poetik: vargje e lirika imagjinative dhe ekzistencialiste të shkruara zakonisht në vetën e parë. Turner, ndoshta, më shumë se çdo poet tjetër mban përgjegjësinë e rikthimit të formave të reja poetike, që sot gjejmë të aplikuar në poezinë bashkëkohore.

Gjeko Marinaj,  
nga parathënia e librit



#### Kanë thënë për poetin Turner

James Merrill,  
"Madhështor, i përfllakur...  
njëmijë herë Bravo!"


Tom Disch,  
"Ka fare pak të barabartë me të  
në poezinë angleze të kohës  
sonë... Poezia e tij është në lartësi  
të pakrahueshme."

Paul Lake

"Si eklogët e mëdhenj të së  
kaluarës, poezitë e tij të natyrës  
dhe lirikat medituese janë të  
mbushura me një vizion të fuqishëm  
etik... Turner ka marrë  
përsipër sfidën më antike të poetit,  
duke na dhënë poezi që janë sa të  
fuqizuara me intelekt aq edhe  
formalisht sfiduese."

## Poeti i Turner këndon shqip

"Si eklogët e mëdhenj të së kaluarës, poezitë e tij të natyrës dhe lirikat medituese janë të mbushura me një vizion të fuqishëm etik... Turner ka marrë përsipër sfidën më antike të poetit, duke na dhënë poezi që janë sa të fuqizuara me intelekt aq edhe formalisht sfiduese"



## Lezhë: Shpirti i popullit - kënga e tij

Ansambli artistik "Çiftelia" i rrethit të Lezhës në 40-vjetorin e themelimit, dekoruar me urdhërin "Naim Frasheri" te klasit II

**LEZHË:** "Katund e kostum, shtëpi e çifteli", ky ishte lajtmotivi i realitetit artistik të Lezhës, që bëri pagëzimin e Ansambli "Çiftelia", me 16.5.1966. Artdashësit lezhjanë, e mirëpritën premierën e parë të këtij Ansambli, titulluar: "Çiftelia" "Brigjeve të Drinit" me 16.5.1966, çka rriti besimin e amatorëve, për të vazhduar më tej veprimtaritë artistike dhe për ta bërë të njohur këtë Ansambël në mbarë Shqipërinë, e më gjerë. Ansambli folklorik "Çiftelia" i rrethit të Lezhës, në Festivalin e parë Folklorik të Gjirokastrës, me 1968,

mori çmimin e parë të festivalit (Medalje të Artë). Ansambli Folklorik "Çiftelia", Lezhë, në Festivalin e dytë Folklorik, Kombëtar të Gjirokastrës, me 1973, u nderua me flamurin e Festivalit, duke marrë çmimin më të lartë të këtij festivali. Ky ishte nderi i madh, që iu bë këtij ansambli. Ansambli Folklorik "Çiftelia", Lezhë, në Festivalin e tretë Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës

me 1978, mori çmimin e tretë të Festivalit, duke i sjellë Lezhës për herë të tretë një vend nderi në garën e grupeve mbarëkombëtare. Ansambli Folklorik "Çiftelia" Lezhë, në Festivalin e katërt Folklorik të Gjirokastrës me 1983, u nderua me çmim të parë për kostumet kombëtare. Ansambli Folklorik "Çiftelia" Lezhë, në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, me 1988,

mori çmimin e parë në paraqitjen e kostumeve kombëtare të Lezhës në këtë Festival. Festivali Folklorik i Vendeve Mesdhetare, në qytetin Agrixhento, Itali me 1993, në të cilin mori pjesë edhe Ansambli Folklorik "Çiftelia", Lezhë, si përfaqësues i Shqipërisë. Në këtë takim, publiku folklordashës i këtij festivali, vlerësoi këtë ansambël, për këngët, vallet, meloditë dhe kostumet e

mrekullueshme të trevës, në mbyllje të tij, juria nderoi Ansamblin Folklorik "Çiftelia" me kupën e pjesëmarrjes në këtë Festival. Gjatë 36 viteve të jetës dhe veprimtarisë së ansambli folklorik "Çiftelia", Lezhë, ndihmuan e kontribuan: kompozitori Agim Velaj, shkrimtari Aleksander Banushi, muzikantët Gjergj Lacaj e Laro Sata, poeti që i dha shpirt Ansambli, Dedë Ndue Lazri, Loro

Gjeçi, kostumograf, lahtarët Llesh Prekushi, Gjokë Nonaj, këngëtarët e rapsodët; Drande Gega, Taze Ndoci, Gjergj Frroku, Sandër Frroku etj., Jo pa qëllim në 40-vjetorin e krijimit të ansambli folklorik "Çiftelia" ai u cilësua "pasaporta e identitetit kulturor lezhjan", duke përçuar tek artdashësit dhe në breza këngën burimore folklorike perlën e gurrës popullore të mahnitshme, dekoruar me Urdhrin "Naim Frasheri", të Klasit të Dytë, për veprimtari të shquar artistike, duke mbetur pasaporta e identitetit kulturor lezhjan.

JAK RROZHANI